

PROCEDURAT QË NDJEK GJYKATA NË MARRJEN E VENDIMEVE

I. GJYQTARËT

Në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, civile dhe penale, Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlore respektojnë ligjet procedurale civile dhe penale.

➤ ÇËSHTJET CIVILE

Gjatë zgjidhjes së një mosmarrëveshje civile gjyqtarët zbatojnë parashikimet e Kodit të Procedurës Civile Kreu II nenet 452 – 471 të këtij Kodi. Disa nga këto përcaktime janë të parashikuara si më poshtë vijon:

Neni 460

Shqyrtimi i çështjes në apel

1. Relatori i çështjes në gjykatën e apelit caktohet me short.
2. Relatori cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit.
3. Palët mund t'i kërkojnë me shkrim relatorit përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.
4. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni zbatimin e këtij neni.
5. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit bëhet nga gjykata e apelit me shpallje në ambientet e saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë. Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të gjykatës së apelit, si dhe, nëse ka, edhe në faqen e internetit të gjykatës përkatëse të shkallës së parë, dhe, me njoftim individual në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit. Shpallja ose njoftimi bëhet të paktën 15 ditë para datës së gjykimit.
6. Për çështjet me rigjykim, ose kur është deklaruar riçelja e hetimit gjyqësor, ose kur çmohet të bëhet një gjykim përpara afatit 15-ditor, njoftimi u bëhet drejtpërdrejt palëve, përfaqësuesve të tyre ose prokurorit, sipas rregullave të pjesës I, titulli VI, kreu IV, “Njoftime”, të këtij Kodi.

Neni 465

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel

1. Gjykata e apelit shqyrton çështjen brenda kufijve të ankimit.
2. Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë.
3. Me kërkesë të palëve ose kryesisht, gjykata e apelit riçel pjesërisht ose tërësisht hetimin gjyqësor.

4. Në gjykimin në apel nuk mund të paraqiten kërkime të reja, të shtohen apo të ndryshohen elementët e padisë, me përjashtim të kërimit për shpenzimet e gjyimit në apel.
5. Gjykata e apelit mund të pranojë për shqyrtim fakte dhe prova të reja, nëse:
 - a) pala e interesuar provon se, pa fajin e saj, gjatë shqyrtimit të çështjes para gjykatës së shkallës së parë nuk ishte në gjendje të paraqiste këto fakte dhe/ose prova të reja;
 - b) pala e interesuar i ka kërkuar, por gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me ligjin, nuk i ka marrë këto fakte dhe/ose prova, të cilat kanë rëndësi për çështjen;
 - c) pala e interesuar provon se nuk mund të ishte në dijeni të fakteve dhe/ose provave të reja gjatë gjyimit në shkallën e parë.
6. Kjo dispozitë nuk zbatohet për marrjen e pohimit gjyqësor ose jashtëgjyqësor.

Neni 465/a

Gjykimi në apel në dhomë këshillimi

1. Në rastet kur në Kod parashikohet gjykimi në apel në dhomë këshillimi, gjykimi bëhet mbi bazë aktesh dhe/ose dokumentesh.
2. Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin e përmbledhur dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve, sipas nenit 460, të këtij Kodi, për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes. Palët kanë të drejtë që deri 5 ditë para séances së shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi, të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.
3. Gjykata, në dhomë këshillimi vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debate gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar nëse duhen marrë apo pranuar fakte ose prova të reja, sipas nenit 465 të këtij Kodi.
4. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.

Neni 466

Vendimi i gjykatës së apelit

Gjykata e apelit pasi shqyrton çështjen vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- b) ndryshimin e vendimit;
- c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes;
- ç) prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë në rastet e parashikuara nga neni 467 I këtij Kodi.

➤ ÇËSHTJET PENALE

Në zgjidhjen e një çështje penale e paraqitur për shqyrtim, gjyqtarët zbatojnë parashikimet e Kodit të Procedurës Penale Kreu II nenet 422 – 430/1 të këtij Kodi. Disa nga këto përcaktimeve janë të parashikuara si më poshtë vijon:

Neni 424

Gjykata kompetente

Mbi apelin e bërë kundër vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor vendos gjykata e apelit.

Neni 425

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes

Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë apel.

2. Kur apelues është prokurori ose viktimja akuzuese, gjykata e apelit:

- a) mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose ta rrisë masën e dënimit, të ndryshojë masat e sigurimit dhe të marrë çdo masë tjetër që urdhëron ose lejon ligji;
- b) mund t'i japë dënim atij që është deklaruar i pafajshëm, t'i japë pafajësi për një shkak të ndryshëm nga ai që pranohet në vendimin e apeluar, të marrë masat e treguara në shkronjën "a";
- c) mund të zbatojë, të ndryshojë ose të përjashtojë dënimet plotësuese ose dënimet alternative;
- ç) mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë se ai i kërkuar nga prokurori kur çështja është në kompetencën e saj lëndore. Në këtë rast, gjykata riçel shqyrtimin gjyqësor dhe zbaton parashikimet e paragrafit 2, të nenit 375, të këtij Kodi.

3. Kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar dhe as t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë.

Neni 426

Veprimet paraprake të gjykimit

1. Kryetari i kolegjit të gjykatës së apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati i paraqitjes nuk mund të jetë më I vogël se dhjetë ditë.
2. Urdhri i thirrjes është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk është identifikuar në mënyrë të sigurtë ose kur nuk është saktësuar vendi, dita dhe ora e paraqitjes.

Neni 426/a

Shqyrtimi gjyqësor në gjykatën e apelit

1. Përpara se të fillojë shqyrtimin gjyqësor, kryetari i trupit gjykues kontrollon paraqitjen e palëve. Në rast se palët nuk janë paraqitur, kryetari verifikon nëse njoftimet janë të rregullta dhe nëse mungesa është e justifikuar.
2. Pas verifikimit të palëve dhe legjitimit të tyre, gjykata shpall trupin gjykues dhe deklaron të hapur diskutimin.

3. Kryetari ose anëtari i trupit gjykues relaton në mënyrë të përmbledhur dosjen gjyqësore dhe shkaqet e ngritura në ankim.
4. Kur është bërë ankim vetëm nga njëra prej palëve, fjalën e para e merr ajo. Kur kanë bërë ankim si prokurori, ashtu dhe I pandehuri, i pari e merr fjalën prokurori.
5. Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për atë që janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë.
6. Gjykata mund të urdhërojë palët që të parashtrijnë pretendimet e tyre në mënyrë të përmbledhur, duke caktuar edhe kohën e vlerësuar të mjaftueshme. Palët nuk mund të parashtrijnë në seance shkaqe tej atyre të ngritura në apel.

Neni 428

Vendimi i gjykatës së apelit

1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos:
 - a) lënien në fuqi të vendimit;
 - b) ndryshimin e vendimit;
 - c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit;
 - ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij, ose përfaqësuesit të viktimës akuzuese, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet menjëherë gjykatës së shkallës së parë.

II. KËSHILLI I GJYKATËS SË APELIT VLORE

Në zbatim të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” neni 27 i këtij ligji titulluar “Përbërja e këshillave të gjykatës”, në të cilin parashikohet se:

1. Në çdo gjykatë ngrihet dhe funksionon Këshilli i Gjykatës.
2. Këshilli i Gjykatës përbëhet nga tre anëtarët e mëposhtëm, përveç kur parashikohet ndryshe në pikat 3 dhe 4 të këtij neni:
 - a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës;
 - b) zëvendëskryetari i gjykatës;
 - c) kancelari i gjykatës.

.....

Që prej vitit 2019 pranë Gjykatës së Apelit Vlore është ngritur dhe funksionon Këshilli i Gjykatës së Apelit Vlore i cili në ushtrimin e veprimtarisë së tij, respekton parimin e pavarësisë së gjyqtarëve, shmangies së ndërhyrjes në veprimtarinë gjyqësore dhe parandalimin e konfliktit

të interesit. Këshilli i Gjykatës bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe me institucionet e tjera qëndrore dhe vendore, për të garantuar një gjykatë efikase, transparente, të aksesueshme, të shpejtë dhe të besueshme.

Mbledhjet e Këshillit zhvillohen vetëm kur në të marrin pjesë të tre anëtarët e Këshillit Kryetari, Zëvendëskryetari dhe Kancelari.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës thirret nga kryetari, me iniciativë të tij, në çdo rast që Këshilli duhet të përmbushë një detyrë të përcaktuar në ligj. Kryetari, jo më vonë se tri ditë para zhvillimit të mbledhjes, njofton anëtarët për datën, vendin dhe rendin e ditës. Rendi i ditës përcaktohet nga kryetari, pas konsultimit me anëtarët e tjerë.

Kryetari i Këshillit deklaron fillimin e mbledhjes së Këshillit dhe verifikon prezencën e të gjithë anëtarëve.

Kur përbërja e Këshillit të Gjykatës nuk është e plotë, mbledhja e Këshillit shtyhet për t'u zhvilluar, si rregull, në një ditë tjetër. Kur të tre anëtarët janë prezent, kryetari paraqet çështjet e përcaktuara për shqyrtim në rendin e ditës. Pas miratimit të rendit të ditës, Këshilli vijon me shqyrtimin e çështjeve. Kryetari i Këshillit jep fjalën, drejton debatin dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës. Kryetari kujdeset që fjala të merret sipas radhës, si rregull, pa ndërprerje dhe debat të ndërmjetëm mes anëtarëve të Këshillit. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e Këshillit shprehin qëndrimin dhe votojnë për çdo pikë të rendit të ditës.

Vendimet e Këshillit të Gjykatës merren me shumicën e votave të anëtarëve, nëpërmjet votimit të hapur.

Mbledhjet e Këshillit të Gjykatës regjistrohen audio me ndihmën e një sekretari gjyqësor, Procesverbali përgatitet në mënyrë të përmbledhur, duke pasqyruar pikat kryesore të diskutimit për secilën temë të rendit të ditës, si dhe mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

E gjithë procedura e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit të Gjykatës së Apelit Vlore realizohet në përputhje të plotë me parashikimet në vendimin nr.71, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës".

III. KRYETARI DHE KANCELARI

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre që lidhet me kërkesat e paraqitura nga palët në gjykim apo publiku i gjërë, kryetari dhe kancelari i gjykatës ndjekin të gjithë procedurën e parashikuar nga ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Kur një kërkesë i paraqitet gjykatës për informim nëpërmjet shërbimit postar ose e depozituar personalisht nga pala prane Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun pranë kësaj gjykate, kërkesa protokollohet dhe i dërgohet për tu shqyrtuar dhe cikluar nga ana e Kryetarit të Gjykatës. Më pas sipas ciklimit të bërë nga ana e kryetarit në kërkesë, kancelari merr masat për kthimin e përgjigjeve ku sipas rastit respektohet ligji për të drejtën e informimit, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale etj.

Sipas nenit 3 të ligjit nr.119/2014 të drejtën e informimit e ka:

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

➤ **Mënyrat e dhënies së informacionit nga Gjykata e Apelit Vlore**

Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun pranë Gjykatës së Apelit Vlore, në 3 mënyra:

1. nëpërmjet adresës së email-it zyrtar të gjykatës gjykataeapelitvlore@gjykata.gov.al;
2. nëpërmjet faqes zyrtare të gjykatës www.gjykata.gov.al;
3. nëpërmjet shërbimit postar.

Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuesit:

- a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik(gjykata), përveç rasteve të veçanta;
- b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe nëse ai parashikon një kostë/tarifë gjyqësore ajo merret nga gjykata në respektim të tarifave të përcaktuara sipas ligjit, Udhëzimit Nr.33, datë 29.12.2014 të Ministrisë së Drejtësisë “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore ë Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”.